



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 98, DATË 16.12.2022  
PËR

“MIRATIMIN E NUMRIT MAKSIMAL TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË  
PAGAVE TË BASHKISË GJIROKASTËR PËR VITIN 2023”

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjit Nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Ligjit Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, Vendimit nr. 627, datë 28.09.2022 për disa ndryshime në vendimin nr. 234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, Vendimit nr. 604, datë 14.09.2022 “Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, VKM nr. 465, datë 06.07.2022 Për disa ndryshime në vendimin nr. 175, datë 8.03.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar” i ndryshuar, VKM nr. 624, datë 28.09.2022 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 350, datë 19.4.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, Vendimit nr. 625, datë 28.9.2022 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 165, datë 2.3.2016, të këshillit të ministrave, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, Projektit “Ofrimi i Shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Gjirokastrë”, Aplikimit nr. 3392/1 prot., datë 20.05.2019 për Fondin Social, Njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.5144 prot., datë 29.10.2019, Urdhrit nr.139, datë 28.04.2022 “Për mbylljen fizike të shërbimeve pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore dhe Bashkimit të Dhomave të Tregëtisë dhe Industrisë dhe dhomave të tregëtisë”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 16 : 12 2022,

VENDOSI:

1. Miratimin e numrit maksimal të punonjësve prej 621 (gjashtëqind e njëzet e një), për vitin 2023.
2. Miratimin e nivelit të pagave (klasave, kategorive dhe grupeve) sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Lavdi Hasani